

KALLËZIM PENAL

KALLZUES: Partia Demokratike Dega "Mallakastër"

ME OBJEKT: Kallëzim i veprës penale "Shpërdorim i detyrës",
parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal, *Neni 328*
"Dhenia e shperblimeve dhe e premtimeve", *Neni 328/a*
"Detyrimi për pjesmarrje në veprimtari politike", *Neni 329*
"Kanosja apo dhunimi ndaj pjesmarrësve në zgjedhje",.

KUNDER: [REDAKTUAR] me detyrë [REDAKTUAR]

DREJTUAR: Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier

I nderuar Z. Prokuror,

Bazuar në nenet 280, dhe 283 të Kodit të Procedurës Penale , si dhe neneve 248 ,328,328/a, dhe 329 të Kodit Penal, parashtrojmë këtë kallzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

I. LIGJI I APLIKUESHEM

1.1. Kodi i Procedurës Penale, në nenet 280 dhe 283 parashikon se:

Neni 280

Marrja dijani për veprën penale

Prokurori dhe policia marrin dijani për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.